



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 19.06.2026

PROCESVERBAL

**Konsultim publik për Draftin e Rregullores për Ndryshimin dhe
Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave
01Nr/060/01-22757-1/24 të datës 30.08.2024
I mbajtur më 10.06.2026 (e mërkurë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Konsultimi publik elektronik dhe me shkrim për Draftin e Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01Nr/060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024, ka zgjatur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data 26.05.2026 deri më 10.06.2026. Publikimi i njoftimit për konsultim publik është bërë më datën 26.05.2026, në platformat zyrtare të Komunës.

Njoftimi në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Njoftimi-i-protokolluar.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Obavestenje-i-protokolluar.pdf>

Njoftimi në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1EeRjn9tfS/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1LYqvBg92Q/>

Drafti i publikuar në rubrikën për konsultime publike:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Propozim-rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave.docx>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Propozim-rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave-SRB.docx>

Diskutimi publik është mbajtur më **10.06.2026, e mërkurë**, dhe ka filluar në **ora 11:00**.

Në këtë diskutim publik kanë qenë prezentë **20 pjesëmarrës, prej tyre 20 meshkuj dhe 0 femra**.

Hapjen e takimit dhe prezantimin e draftdokumentit e ka bërë menaxheri i Njesisë së KRM “Ekoregjioni” në Dragash, në cilësinë e propozuesit dhe anëtarit të Komisionit për hartimin e Draftit të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave 01Nr/060/01-22757-1/24, të datës 30.08.2024.

Nazim Dauti: Po shfrytëzoj nga rasti t’i përshëndes të gjithë pjesëmarrësit! Ju e dini të gjithë që ne, kompania “Ekoregjioni”, jemi duke e kryer shërbimin e mbledhjes së mbeturinave në të gjithë territorin e Komunës. Tashmë komplet territori i Komunës është në sistem, nuk ka asnjë fshat që është jashtë sistemit. Mirëpo, edhe ne si ndërmarrje jemi duke u ballafaquar me problemet e kohës, sepse janë ngritur çmimet e pothuajse të të gjitha produkteve, dhe kemi nevojë për një ristrukturim të Rregullores, tek çmimi, për arsye se me çmimin aktual që është – siç e dimë, 5.50 euro për amvisëri – ne kemi ardhur deri tek një gjendje që nuk është shumë e favorshme për ne. Lidhur me këtë, menaxhmenti i “Ekoregjionit” iu ka paraqit kërkesë të gjitha komunave të regjionit, Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë edhe Dragash, që të rritet çmimi për amvisëri. Aktualisht, Prizreni, Suhareka edhe Rahoveci, në kuvendet komunale e kanë miratuar kërkesën e “Ekoregjionit”, e cila kërkesë ka qenë për 7.50 euro për amvisëri. Arsyeja e kërkesës që të rritet, unë e thashë – e dini që është rrit nafta shumë, janë rrit çmimet e veshjeve që i përdorin punëtorët tanë, uniformat. Edhe mirëmbajtja e automjeteve, gjithashtu. Çmimet janë rrit gjithandej. Në fakt, do të duhet patjetër tash të rriten edhe rrogat, sepse prej 1 korrikut rroga minimale do të jetë 500 euro, dhe ne jemi të detyruar me e respektue ligjin. Kështu që, kur t’i mbledhim të gjitha këto, ne mund të vijmë tek një gjendje e vështirësuar financiare. Pra, kjo është arsyeja pse ne kemi kërkuar që të rriten tarifat. Tash ka mbetur vetëm Dragashi pa e miratuar këtë kërkesë tonën, pa e shqyrtuar akoma. Kështu që, unë mbes me shpresë që, edhe në Asamblenë Komunale kur te dalë kjo kërkesë, do të gjejë mirëkuptim. Tarifën ne kemi

kërkuar që ta bëjmë 7.50 euro. Për herë të fundit është rrit në vitin 2024, nga 4.50 euro në 5.50 euro. Tash është radha juaj që të jepni komentet dhe sugjerimet.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Duhet ta keni të qartë se këtu kemi të bëjmë me një kërkesë të “Ekoregjionit”, që ia ka drejtuar Kuvendit Komunal. Duhet ta dini se Kuvendi Komunal i Dragashit është aksionar. Kjo nuk do të thotë se është përfundimtare. Përfundimtare kjo kërkesë bëhet kur të miratohet në Kuvend prej delegatëve. Kjo është një kërkesë dhe ne e hapim debatin nëse qytetarët do të pajtohen me këtë kërkesë apo jo. Gjithashtu, pas këtij diskutimi, kërkesat tuaja që qytetarë ne mund t’i plasojmë në Kuvend dhe mund ta diskutojmë edhe çmimin. Përfundimtare është në momentin kur mbahet mbledhja dhe votojnë delegatët për kërkesën e “Ekoregjionit”. Kush do që ta marrë fjalën?

Veton Halili, përfaqësues i fshatit Zaplluxhe: Përsëritet për të gjithë! Unë po e marr fjalën në cilësinë e përfaqësuesit të fshatit Zaplluxhe. Duke i pa rrethanat ekonomike në të cilat ndodhet popullata jonë, unë kisha propozuar që tarifa me qenë 6.50 euro, e jo 7.50 euro. Faleminderit!

Dilber Halimovic, përfaqësues i fshatit Mlikë: Deponit ilegale ndikojn drejtpërdrejt te qytetarët dhe ka pasoja për shëndetin, për shkak të çlirimit të gazrave të ndryshëm dhe ndotjes në përgjithësi. Deponi të egra ka kudo në Gorë. Ne krenohemi se po bëhemi gjithnjë e më shumë një atraksion serioz turistik për ecje malore, çiklizëm dhe mountain bike. Na vijnë edhe motoçiklistë, njerëz që shëtisin nëpër male me kuadra dhe motoçikleta. Dhe çfarë shohin ata në malet tona? Është një pamje e tmerrshme. Në këtë propozim nuk shoh asnjë masë apo propozim për sanksionimin e personave përgjegjës. Të gjithë e dimë se kush janë ata dhe kush po i krijon këto deponi ilegale. Zejtarët dhe kompanitë që kryejnë punime kanë deponi të caktuara; sa di unë, janë dy të tilla – një afër Zhurit dhe një tjetër te kthesa për në Opojë. Askush nuk dëshiron ta dërgojë mbeturinën atje. Një nga propozimet e mia është që të gjitha këto vende të pastrohen përsëri. Janë vendosur tabela, por ndoshta jo të përshtatshme. Tek ne shkruan: “Këtu është vendi për mbeturina”, dhe pastaj është një shportë, ku dikush duhet të kuptojë se mbeturinat duhet të hidhen brenda saj. Por kur shkruan “Këtu është vendi për mbeturina”, njerëzit tanë nuk lexojnë më tej, por i hedhin menjëherë mbeturinat aty pranë. Ka divane, shporete dhe lloj-lloj gjërash. Më së shumti ka mbeturina nga materialet ndërtimore. Sa u përket këtyre deponive, do të propozoja që e njëjta kompani, nëse është përgjegjëse për këtë çështje, të merret më shumë me pastrimin e tyre sesa me rritjen e çmimeve për ne qytetarët, të cilat sipas mendimit tim janë paksa të larta dhe jo të përshtatshme. Jam dakord që karburanti është shtrenjtuar, ndoshta edhe do të lirohet në të ardhmen. Shpenzimet janë rritur. Ata nuk kanë aq shumë punonjës sa që ne të bartim mbi vete koston e uniformave, mantelave, këpucëve dhe gjithçkaje tjetër. Pajtohem që punëtorët

duhet të kenë kushte të mira pune dhe paga të mira. Paga mesatare mund të jetë rreth 500 euro. Por këtu në Gorë jetojnë kryesisht pensionistë, të cilët mbijetojnë me rreth 150 euro për anëtar të familjes. Kanë fat nëse janë dy persona në familje, ndërsa nëse është vetëm një person, atëherë ai duhet të jetojë vetëm me ato të ardhura.

Beqir Beqaj, drejtor i Radio Sharri: Përshëndetje të gjithëve! Unë, duke e parë këtë ndryshim, nuk vërejta ndonjë ndryshim që ka të bëjë me mirëqenien e qytetarit, por këtu është synim që vetëm të ngritet çmimi. Në parim, unë jam dakord edhe 10 euro të bëhet çmimi. Por, për atë çmim, çfarë shërbim po marrim?! E para që nuk është në rregull dhe mund ta quaj edhe diskriminim, është fakti se, në Dragash, çdo ditë zbrazen kontenierët, mblidhen mbeturinat, e nëpër fshatra është një herë në javë, dhe çmimi është i barabartë. Që domethënë se qyteza e Dragashit është e privilegjuar. Në, një javë ditë i durojmë në shtëpi mbeturinat, për t'i nxjerrë pastaj në vendet ku na është caktuar që t'i vendosim aty. Dhe, për çudi, bëhet riciklimi, nuk i marrin të gjitha. Herët e fundit kam parë unë një grusht sanë, bar i thatë, e kanë lënë, nuk e kanë marrë. Kurrfarë dëmi nuk bën ajo, një grusht, një karrocë e vogël. E kuptoj, beton, gur, kauqa e gjëra të tjera që i hedhin, e që nuk i marrin. Këtë e kuptoj, por atë nuk e kam kuptuar. Pra, të mos bëhet riciklimi, por t'i marrin ashtu siç duhet. Problemi tjetër në Bellobrad – madje, në shenjë proteste, një kohë të gjatë nuk kam paguar – sepse, unë paguaj dhe, ata që nuk paguajnë e nuk i ndëshkon askush, i hedhin pranë shtëpive tona. Përveç asaj, ua fusin edhe zjarrin, tymi kundërmon në familje, ne detyrohemi të mbyllemi brenda sepse në oborr nuk mund të qëndrosh nga ai tym. Dhe tash, unë të paguaj dhe të dëmtohem nga ai tjetri që nuk paguan dhe askush nuk e ndëshkon, edhe këtë fakt nuk e kam pranuar. Një problem tjetër që është shumë i madh, e që prisja me këtë Rregullore që të rregullohet, janë mbetjet inerte. Ta paktën, meqë vetëm katër herë në muaj vijnë nëpër fshatra, të paktën një herë në muaj të caktohet një datë kur banorët mund t'i nxjerrin këto mbetje, që “Ekoregjioni” t'i mbledhë ato. Sepse, ne kemi më shumë problem nga këto mbetje sesa nga mbeturinat e amvisërisë. Si përfundim, unë, çfarëdo që do të vendosë edhe Kuvendi, natyrisht, ligji është ligj, do ta zbatojmë. Por, ajo që mbeta i pakënaqur është fakti se këtu nuk ka ndonjë ndryshim pozitiv në të mirë të qytetarit, por vetëm po kërkohet rritja e çmimit, siç ndodhi afërsisht në Suharekë, kur deri e rritën çmimin, një muaj pothuajse nuk i morën mbeturinat dhe u detyruan të rrisin çmimin. Kërkoj që në këtë Rregullore të shqyrtohen edhe këto propozime të qytetarëve. Të paguajmë po, edhe një herë po e përsëris, edhe 10 euro e paguaj, por jo të kundërmojnë mbeturinat e tjetrit pranë shtëpisë sime, dhe jo të mbushet natyra me mbetje inerte, sepse nuk ka ndërmarrje që i mbledh ato. Faleminderit!

Sehat Ibraimi, përfaqësues i Dragashit të Poshtëm: Unë jam Sejati Ibraimi dhe vij nga Dragashi. Fillimisht do të përshëndes kryetarin, drejtorët dhe zotërinë menaxher nga Eco Regjioni. E dëgjova me kujdes menaxherin e Eco Regjionit dhe, përveç rritjes së çmimit, nuk dëgjova asgjë tjetër në arsyetimin e tij se çfarë do të përfitojnë më shumë qytetarët, përveç faktit që në të ardhmen do të paguajnë 2 euro më shumë. Unë, si qytetar i Dragashit dhe dëshmitar i asaj që u tha nga folësi i mëparshëm, z. Dilba, mund të them se në Dragash, aty ku ka kontejnerë për mbeturina, vijnë ndërtues dhe zejtarë nga qendra e qytetit dhe hedhin mbeturina, ndërsa askush nuk i sanksionon. Do të propozoja që, në rregull, pajtohem me rritjen e çmimit, por do të insistoja në rritjen e aktiviteteve të Eco Regjionit përmes një forme mbikëqyrjeje dhe inspektimi. Dragashi duhet të monitorohet me kamera dhe me të gjitha mjetet e nevojshme. Unë nuk e di nëse në katër vitet e fundit është sanksionuar dikush për hedhje të paligjshme të mbeturinave. Njerëz nga fshatra të tjera vijnë, parkojnë pranë kontejnerëve dhe shkarkojnë sasi të mëdha mbeturinash, kështu që ne qytetarët e Dragashit, të cilët paguajmë rregullisht shërbimin, nuk mund t'i hedhim mbeturinat tona. Ose detyrohemi t'i lëmë në vende të papërshtatshme pranë kontejnerëve, gjë që nuk është në përputhje as me kulturën dhe as me mbrojtjen e mjedisit. Prandaj propozoj që, nëse rritet çmimi, Eco Regjioni të organizojë një inspektim të rregullt, qoftë në bashkëpunim me komunën apo brenda vetë kompanisë, duke angazhuar inspektorë që do të dalin herë pas here në terren, në përputhje me ligjin, për të kontrolluar se ku dhe si po hidhen mbeturinat. Unë mendoj se kjo situatë e ka kaluar çdo masë. Sa i përket çmimit, ndoshta është një barrë për pensionistët, por për qytetarët në përgjithësi nuk është një çmim i lartë, nëse shërbimi i Eco Regjionit ofrohet në nivel të lartë. Faleminderit.

Burim Piraj, pronar i kompanisë MEKA: Përshëndetje, unë jam Burim Piraj, pronar i kompanisë MEKA, e cila merret me përpunimin e mishit. Unë po mendoj se prezantimi i drejtorit ka qenë jo i plotë. Ne nuk e dëgjuaam nga drejtori se sa konsumatorë ka gjithsej, sa shtëpi janë, sa ka të ardhura gjithsej. Na tregoi se është shtuar numri i konsumatorëve, nga ana tjetër është shtuar kërkesa për rritjen e çmimit. Është një prezantim i pamjaftueshëm dhe mendoj se duhet ta përgatitin një prezantim tjetër, ku duhet ta njoftojnë opinionin publik për të gjitha të ardhurat saktësisht sa i kanë në Komunën tonë, sa punëtorë i kanë, sa harxhime kanë, edhe mandej të bëhet kërkesa reale për ngritje të çmimit. Unë mendoj se çdo ngritje mbi 10% është shumë, por pasi këta kanë pas rritje të konsumatorëve, ndoshta ai 10%-shi është i panevojshëm për t'i arritur ato synimet e rritjes së pagave minimale që i tregoi. Ne si kompani, normal që paguajmë çmim tjetër. Por kurrë nuk na kanë pyet, edhe pasi që është Komuna bashkëmenaxhuese e mbeturinave, ne paguajmë 320 euro në muaj pa na pyet kërkuar çmimin a bën me e rrit, a s'bën me e rrit. E kanë rrit qysh dojnë. Çka është e keqja më e madhe, ne jemi kompani që

kemi edhe mbeturina shtesë. Drejtori i cili është prezent, neve nuk na lejon me i qit mbeturinat te mbeturinat e Sharrit, as nuk na cakton çmimin – me thënë, për shembull, ne kemi pas pastrim të gropave septike – nuk lejon fekalet me i qit në mbeturina, ne shkojmë në Prizren, paguajmë në Prizren me i qit. Nuk jep përgjigje hiç, vetëm thotë nuk bën me i qit edhe pikë. Kjo është shumë e papërgjegjshme, për një fabrikë që është këtu në Dragash, me shkue me i çue mbeturinat në Prizren. Është një papërgjegjësi shumë e madhe dhe një mosmirënjohje për kontributin që e japim. Ne i kemi mbi 80 punëtorë dhe duhet të kihet parasysh që nuk është hajgare një kompani në Sharr me qenë me 80 punëtorë edhe me qenë inorant ndaj asaj kompanie. Prandaj, unë nuk do të shtoja asgjë më shumë, përveç asaj se çdo rritje mbi 10% është e pakuptimtë, por prapë po propozoj edhe një herë një rishikim edhe një prezantim të sërishëm të kompanisë “Ekoregjioni”, për të ardhurat që i kanë edhe për të ardhurat që po synojnë t’i kenë në Komunën tonë, e pastaj të bisedojmë për rritje ose mosrritje. Faleminderit!

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Faleminderit! Të gjitha vërejtjet realisht ishin me vend, mirëpo disa gjëra duhet t’i sqarojmë. Ju duhet ta dini se ne kemi të bëjmë me mbetje inerte dhe me mbetje të ekonomive familjare. Deponia të cilën e kemi atje merret me grumbullimin e mbetjeve të amvisërisë. Me deponitë inerte kemi problem dhe jemi në proces e sipër, si Komunë, ku i kemi projektuar dy deponi inerte, sepse deri më tash kompanitë të cilat i kemi dënuar, faktikisht gjykata na i ka kthye prapë, ngase nuk kemi një adresë të rregullt ku t’i drejtojmë ato kompani për me i qit mbetjet. Por, gjithashtu, në ekonomitë familjare, ju duhet ta dini që edhe sot e kësaj dite, edhe tetë fshatra jemi në përpjekje për me i shti në sistemin e pagesave, sepse nuk kanë nënshkruar kontratë dhe nuk kanë bërë pagesa. Për momentin Komuna është duke ua mbuluar shpenzimet, me kusht që ata të hyjnë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Pra, ne jemi në një proces të vazhdueshëm që ta zgjidhim këtë problem. A jemi të kënaqur? Realisht nuk jemi të kënaqur. Ka shumë vërejtje të cilat ju i thatë. Por, a është bërë përmirësim prej se kemi ardhur? Unë mendoj se përmirësimet janë të dukshme. Ne i kemi gjet gjysmën e fshatrave të cilat nuk kanë qenë të hyra në sistem, dhe tash kanë mbetur edhe tetë fshatra, që besoj se në fund të vitit do të kalojnë dhe të fillojnë edhe ta bëjnë pagesën edhe ato, edhe të mblidhen të gjitha, t’i kemi në sistem. Pasi t’i kemi të gjitha fshatrat në sistem, t’i ndërtojmë edhe dy deponi për mbetje inerte që janë të planifikuara, do t’i angazhojmë edhe inspektorët më shumë, që të intervenojnë, se kemi ligjërisht të drejtë t’i dënojmë ato. Sa i përket pyetjes se a kemi dënuar dikënd, ne kemi dënuar disa kompani. Realisht, nuk kemi qenë të kënaqur as me dënimin, por në fakt, kur i kemi kqyr në gjykatë, ajo na ka kthye prapë. Sepse, derisa Komuna nuk e ka ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për mbetjet inerte, faktikisht na janë kthyer të gjitha prapë. Disa herë e kemi bërë pastrimin e mbetjeve inerte me buxhet të Komunës. E di edhe

parafolësi, që edhe par mbajtjes së Panairit jemi detyruar që ta angazhojmë kompaninë private me tri oferta, vetëm që t'i heqim mbetjet inerte që po na i hedhin edhe në vendet e dukshme. Ju e dini që Komuna jonë, përpos natyrës që e ka të bukur, asgjë tjetër nuk ka, edhe atë nuk jemi në gjendje me e mbajt, kemi fillue me e dëmtue. Disa herë kemi intervenue edhe nëpër fshatra të ndryshme, disa deponi ilegale që funksionojnë t'i mbyllim, si në Zaplluxhe, në Kosavë, rrugës për në Restelicë. Kemi bërë sa kemi mundur, por këto janë kapacitetet. Një zgjidhje përfundimtare nuk e kemi, dhe përderisa nuk e kemi, do të kemi probleme. Nuk jam për ta bërë avokatin e “Ekoregjionit”, mirëpo grumbullimi i mbeturinave është bërë në masën më të mirë sesa ka qenë, por ka edhe probleme, sikur e paraqitën, se disa raste nuk lejohen edhe disa mbetje. Nuk e di atë Rregullore, për më shumë do t'ia jap fjalën drejtorit që ta sqarojë. Prandaj, unë mendoj se një bashkëpunim më i mirë i qytetarëve, i kompanisë edhe i Komunës, që të mund ta tejkalojmë këtë situatë, derisa t'i ndërtojmë këto dy deponitë për mbetje inerte dhe ta bëjmë një zgjidhje pak më afatgjate. Edhe unë pajtohem që drejtori të na bjer një raport më të detajuar, që ta çojmë në Kuvend dhe ta bëjmë publik. Ndoshta sot nuk e ka, por po i japim një mundësi që ta paraqesë në Kuvend, sepse kemi të drejtë, meqenëse jemi aksionarë, të kërkojmë një raport të detajuar financiar dhe me problemet të cilat i kanë. Dhe, të diskutojmë, sepse është në shërbim të qytetarëve tanë.

Nazim Dauti: Unë fillimisht po ju njoftoj se “Ekoregjioni” është kompania e cila merret vetëm me mbledhjen dhe transportin e mbeturinave. Unë i pashë këtu ankesat e qytetarëve, që po bëhen deponi ilegale, dënime ose kushedi çka, mirëpo ne nuk kemi asnjë lloj kompetence me e dënue një qytetarë nëse i hedh mbeturinat diku në natyrë. Për atë punë është Inspektorati. Ne vetëm e bëjmë shërbimin, mbledhjen dhe transportin e mbeturinave deri te deponia. Sa i përket çmimit, pat edhe pajtime edhe mospajtime, mirëpo çmimi është akoma si draftpropozim, që ne si Komision pastaj do ta diskutojmë, do të merren parasysh edhe kërkesat dhe vërejtjet tuaja, dhe do të shohim se çfarë lloj çmimi do të mund t'i paraqesim për propozim Kuvendit Komunal, që të votohet. Banori i fshatit Mlikë tha se janë krijuar deponi. Unë nuk e di, neve na është thënë me e bo një incizim të deponive ilegale ku janë, dhe do të merret një aksion për eliminimin e këtyre, për aq sa mundemi. Mirëpo, problemi tjetër është se – mirë e tha edhe vetë qytetari – që sa po eliminohen, po rikrijohen. Por ato është kompetencë e Komunës e cila, përmes Inspektoratit, në të ardhmen besoj se do të mund të marrë masa, sepse edhe te ky propozimi këtu është Pika 2.2., për shkelësit e dispozitave inspektori komunal shqipton gjoba. Domethënë, edhe kjo do të futet në Rregulloren e re, është propozuar që të merremi pak më shumë me këta shkelësit e ligjit. Beqir Beqaj tha se nuk pajtohet që në Dragash po merren përditë, e nëpër fshatra një herë në javë. Kjo është në krejt Kosovën. Është e rregulluar me Rregullore, këtu interferojnë të gjitha kompanitë në nivel të Kosovës që e bëjnë mbledhjen e mbeturinave. Tash, a

përmirësohet kjo apo ndodh diçka, unë nuk e di për atë. Sa i përket kompanisë MEKA, pajtohem që, ndoshta, është dashtë me ardhë pak më i përgatitur, me raporte, sa i përket kompanisë. Gjithsesi, nëse do ta kemi një takim tjetër, do të jemi më të përgatitur, me raporte detale. Ndërsa, sa i përket përcaktimit të çmimit, në Rregulloren e 2016-tës ka qenë që shërbimet e bizneseve me kontrata që janë me kontenierë, një kontenier, një zbraze paguhet 11 euro, ndërsa me Rregulloren e vitit 2024 është 13 euro. Unë kam pas takim me Bejtulla Pirajn, kur e kemi bërë caktimin e çmimit. Kur e kemi bërë një llogaritje sipas kontenierëve, kompanisë MEKA i ka ra ma shumë se 1000 euro në muaj të paguajnë mbeturina. Për shkak se MEKA si kompani jep kontribut në Komunën tonë, ne jemi dakorduar që të mos shkojmë me kontenierë sepse po i del shumë çmimi, e kemi gjet një çmim të përafërt, që është 320 euro në muaj. Edhe, jemi dakorduar me Bejtulla Pirajn si përfaqësues i kompanisë MEKA, edhe e kemi nënshkruar kontratën. Unë do t'ia ofroj kompanisë MEKA Rregulloren për mbeturina, që të shihen se cilat lloje të mbeturinave nuk lejohen të zbrazen në deponi. Besoj se do të jem korrekt edhe me këtë, sepse një cisternë që më është kërkuar me e shkarkue në deponi para disa ditëve, unë u kam treguar qartë atyre që më kanë pyet, se këto materiale që sipas Rregullores nuk lejohen të derdhen në deponi. Ndryshe, kompanisë MEKA unë besoj që i shërbejmë shumë mirë, ia marrim mbeturinat për çdo ditë. Tash, për vërejtje, gjithsesi i pranojmë sa i përket shërbimit tonë.

Vetim Ramadani, nënkryetar i Komunës së Dragashit: Përsëritet për të gjithë! Meqenëse sot jemi mbledhë me e diskutue çështjen e tarifës së “Ekoregjionit”, ne e dimë fare mirë se kjo kompani operon në Komunën e Dragashit dhe ne jemi njëra ndër komunat ku operon “Ekoregjioni”. Mirëpo, ne e kemi hisen tonë, sepse jemi aksionarë. Dhe, të qenurit aksionarë shpeshherë na jep edhe të drejtën me dhënë kritika, edhe me dhënë sugjerime. Unë absolutisht pajtohem me të gjitha propozimet këtu që ishin, edhe sa i përket diskutimit të shërbimeve. Ne sot, është fakt që jemi mbledhë me i diskutue tarifat, mirëpo kjo nuk na ndalon që t'i diskutojmë edhe shërbimet, sepse tarifat lidhen me shërbimet. Kërkesa që i është bërë Drejtorisë për Shërbime Publike, ka qenë një propozim që të ketë një ngritje deri në vlerën 7.50 euro. Ne i kuptojmë, se zakonisht ngritjet bëhen për qëllime të inflacionit. Ne e dimë fare mirë, kemi ngritje edhe në shpenzime komunale. Po ashtu, jemi në njohuri, meqenëse kemi si Komunë një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me “Ekoregjionin”, ne kemi po ashtu edhe kontratat për shërbimet e varrimit, që e kemi një Memorandum Bashkëpunimi me “Ekoregjionin”. Kemi edhe kontratën e pastrimit të qytetit, edhe për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta të Komunës. Praktikisht kemi një mori shërbimesh dhe deri më tani jemi të kënaqur sa u përket këtyre shërbimeve. Tema e mbeturinave është pak më e ndjeshme, mirëpo, megjithatë, unë kisha propozuar – sepse kjo vlerë është jashtëzakonisht e lartë – të shkojmë së paku me përgjysmimin e vlerës, përkatësisht ta

propozojmë vlerën prej 6.50 euro. Ky është vetëm një propozim, nuk do të thotë se është kaluese. Sa u përket shërbimeve, unë absolutisht pajtohem, ashtu siç e tha edhe Drejtor Qamili, edhe me kërkesat e kompanisë MEKA. Ajo është njëra ndër kompanitë më të suksesshme në nivel të Kosovës, jo vetëm në Komunën e Dragashit, ne jemi me fat që e kemi. Duhet me e bo maksimumin që me ia sigurve lehtësirat e nevojshme sa i përket marrjes së mbeturinave. Unë, atë që e kisha kërkuar prej përfaqësuesit të “Ekoregjonit”, është që neve, siç e tha drejtori, në mbledhjen e Asamblesë Komunale, të na sjellë një raport detal për shërbimet, për numrin e ekonomive familjare, individëve, banorëve jorezidentë, dhe të gjitha statistikatat sa i përket edhe qarkullimit financiar që e keni pas, në mënyrë që kjo kërkesë të jetë e arsyetuar dhe e bazuar edhe sa i përket shtrirjes ndër vite të tarifave. Kisha dashtë me u ndërlidhë edhe me pronarin e kompanisë MEKA. Ai e ngriti edhe një çështje jashtëzakonisht logjike, që ishte çështja e kërkesës së ngritjes së çmimeve, ndërsa në anën tjetër po rritet numri i konsumatorëve. Realisht, ne si qeverisje kemi bërë përpjekje, edhe mandatin e kaluar por edhe gjatë këtij mandati, synim i yni do të jetë që të gjithë fshatrat të jenë në sistemin e mbledhjes së mbeturinave nga “Ekoregjioni”. E vetmja platformë që mund ta sigurojë një gjë të tillë është kompania “Ekoregjioni”. Ne si Komunë nuk kemi resurse komunale, e as njerëzore, edhe teknike, që ta sigurojmë mbledhjen e këtyre mbeturinave. Si pasojë e kësaj, në mënyrë që ta bëjmë më atraktiv – sepse nuk është lehtë që një fshat ta inkorporosh në sistemin e mbledhjes së mbeturinave – ne kemi përdorur praktikën që, fillimisht t’i marrim shpenzimet ne si Komunë, e pastaj t’ua kalojmë në participim qytetarëve në bashkëpunim me “Ekoregjonin”. Mirëpo, atë që deshta unë ta them është se, me rritjen e numrit të konsumatorëve, është rrit edhe harta e marrjes së mbeturinave. Ta zëmë, për shembull, në fshatin Pllajnik, në qoftë se nuk ka shkue ma herët, është fakt se janë rrit konsumatorët, mirëpo është rrit edhe rruga, edhe ajo ka kosto. Pastaj është ngjesh edhe kalendari. E këtu ndërlidhem edhe me fjalën e z.Beqaj, i cili me të drejtë e ngriti çështjen që në Dragash pastrohet edhe i rrijnë jashtëzakonisht gati, mirëpo në fshatrat tjerë kemi probleme. Unë vij prej fshatit Blaç, ku një herë në javë grumbullohen mbeturinat. Edhe ka rastë që dy-tri ditë qëndrojnë të ekspozuara për arsye se nuk ka shërbim. Nuk po dua ta adresoj fajin kryekëput te “Ekoregjioni”, ndoshta ju edhe nuk i keni mundësitë logjistike me e përballue një gjë të tillë, por duhet me e hartue një strategji dhe një plan më konkret se si do të mundim – meqenëse ju keni statistika se në cilat fshatra ka më shumë kërkesa. Ose në fshatrat në të cilat janë të fokusuara më shumë bizneset. Ta zëmë, e kemi fshatin Buzez që për nga numri i banorëve është jashtëzakonisht i vogël, mirëpo aty operojnë jashtëzakonisht shumë biznese, edhe ma shumë biznese, ka më shumë mbeturina. Kisha pas qef që t’i keni parasysh këto vërejtje, dhe në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale të jeni më ekspeditiv dhe më i detajuar. Megjithatë, unë i qëndroj atij propozimi që thashë më herët, që duhet të rritet, meqenëse, thuajse në secilin sektor

kemi ngritur tarifat, duke përfshirë të fundit edhe planifikimin për transportin e nxënësve. Për afër 30-40 mijë euro ka ndryshuar kostoja e përgjithshme e transportit të nxënësve, meqenëse janë ngritur çmimet edhe të mirëmbajtjes, edhe të derivateve. Faleminderit!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e diskutimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: [https:// dragash.rks-gov.net/ news/ u-mbajt-konsultimi-publik-per-draftin-e-rregullores-per-ndrysbimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-per-menaxhimin-e-mbeturinave/](https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultimi-publik-per-draftin-e-rregullores-per-ndrysbimin-dhe-plotesimin-e-rregullores-per-menaxhimin-e-mbeturinave/)

Boshnjakisht: [https:// dragash.rks-gov.net/ sr/ news/ odrzana-je-javna-konsultacija-o-nacrtu-pravilnika-o-izmjename-i-dopunama-pravilnika-o-upravljanju-otpadom/](https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzana-je-javna-konsultacija-o-nacrtu-pravilnika-o-izmjename-i-dopunama-pravilnika-o-upravljanju-otpadom/)

Në Facebook:

Shqip: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 1CsCpYdmVy/](https://www.facebook.com/share/p/1CsCpYdmVy/)

Boshnjakisht: [https:// www.facebook.com/ share/ p/ 1En8iemeBw/](https://www.facebook.com/share/p/1En8iemeBw/)

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në diskutim publik dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 10.06.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESEMARRESVE NË DISKUTIMIN PUBLIK PËR
RREGULLOREN PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E RREGULLORES
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 01.NR.060/01-22757-1/24 E
DATËS 30.08.2024

LISTA UÇESNIKA NA JAVNOJ RASPRAVI ZA PRAVLNIKA O DOPUNI
I IZMENI PRAVLNIKA O UPRAVLJANJU OTPADOM BR. 01.NR.060/01-
22757-1/24 OD 30.08.2024. GODINE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	BURIM PIRAJ	PLAVE	SHQIPTAR	✓		
2	Redi HADRI	Kosovë	Shqiptar	✓		
3	ARDIT KRANODARI	KOSOVË	Shqiptar	✓		
4	Dreni Myrkez	ZAPLLUXH	SHQIPTAR	✓		
5	Veton Halili	Zaplluxhe	Shqiptar	✓		
6	Arbend Haxhiu	Busc	Kosovar	✓		
7	Artur Sanderi	Dikane	Goranac	✓		
8	VILBER HADIMOVIC	MALKE	QERKINAC	✓		
9	Bedir Vllasi	Shajm	Shqiptar	✓		
10	Armond Sylgjari	Plac	Shqiptar	✓		
11	Enver Haxhiu	Zaplluxhe	Shqiptar	✓		
12	Behar Salmani	KUR	Shqiptar	✓		
13	Mehmet Beuthe	Busc	Shqiptar	✓		
14	Rafiq Hoxhaj	Kosovë	Shqiptar	✓		
15	FARU REXHANI	Kosovë	Shqiptar	✓		
16	SEHAJ IBRAHIM	ORNG.	Gor.	✓		
17	SULEJ REXHANI	Ripet	Bosht	✓		
18	BEQIR BEQAJ	Bellubrad	Shqiptar	✓		
19	Germond Komani	BIRUT	Shqiptar	✓		
20	Adem Emin	Zatav	Shqiptar	✓		
21	REPUBLIKA E KOSOVËS					
22	REPUBLIKA KOSOVA					

Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 352/01-10172/26/1

10.06.2026

Dragash - Dragaš



